

20161633632

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM
RURAL

Neni 1

Në Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 49/10, 53/11, 126/12, 15/13, 69/13, 106/13, 177/14, 25/15, 73/15, 83/15, 154/15, 11/16, 53/16 dhe 120/16) në nenin 14 paragrafi (2) pas fjalës "zhvillim" shtohen fjalët: "përveç shfrytëzuesve të ndihmës për humbje të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe ngjarjet e pavoritshme klimatike dhe shfrytëzuesve të ndihmës plotësuese për pagesën e humbjeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe ngjarjet e pavoritshme klimatike".

Në paragrafin (3) pas fjalës "zhvillim" shtohen fjalët: "përveç shfrytëzuesve të ndihmës për humbjet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe ngjarjet e pavoritshme klimatike dhe për shfrytëzuesve të ndihmës plotësuese për pagesë të humbjeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe ngjarjet e pavoritshme klimatike".

Neni 2

Në nenin 99-b paragrafët (4) dhe (5) shlyhen.

Neni 3

Procedurat e filluara për ndihmë për humbjet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe ngjarjet e pavoritshme klimatike dhe procedurat për ndihmë shtesë për pagesë të humbjeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe ngjarjet e pavoritshme klimatike deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të përfundohen në pajtim me Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 49/10, 53/11, 126/12, 15/13, 69/13, 106/13, 177/14, 25/15, 73/15, 83/15, 154/15, 11/16, 53/16 dhe 120/16).

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi në ditën botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".